



Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received/Delivered	15.09.2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHC	5429/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 708/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Malsore Gashi – Bajraktari kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi, dhe Arben Mehmeti anëtarë, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1612/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.782/2019 të datës 31.12.2019 të ankuesit me adresë banimi nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 15.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Udhëheqësi i Njëjesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e vendimit brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë deklarinimin e statusit të zyrtarit publikë/ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën I të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.05.2021 ka nxjerr Vendim A.nr. 345/2021, përmes të cilin ka shpallur veten jo kompetentë për të vendosur për ankesën me numër A.nr. 782/2019 të datës 31.12.2019 të ankuesit

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me datë 08.07.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1612/2021, me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke anuluar Vendimin A.nr. 345/2021 të datës 31.05.2021 të Këshillit, me detyrimin që të detyroj organin e punësimit që



në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të nxjerr akt administrativ, duke i përshtatur rregullat me statusin e duhur të punësimit.

Administrimi i provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: ankesës A. Nr. 708/2022, të datës 15.08.2022, Aktgjykimin A.nr. 1612/2021, e datës 08.07.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, Ankesën Nr. A Nr. 345/2021, e datë 30.04.2024 me numër protokolli 2122/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas Aktgjykimit Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative të datës 26.03.2021; Ankesa e datës 31.12.2019, me numër protokolli 5966/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 09.01.2020; me numër protokolli 41/2020; Kontrata e punës e datës 03.12.2019; Akt emërimi i datës 01.03.2013; Aktvendimi A. Nr. 1612/2021 i datës 10.05.2022, Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Padi e datës 15.04.2022 drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi A.nr. 345/2021 të datës 31.05.2021, e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.1612/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që të detyrohet organi punëdhënës të nxjerr aktin administrativ, **SEPSE:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, konstaton se ankuesi në bazë të akt emërimit të datës 01.03.2013, mbanë pozitën “Tonist Elektrecist – garderober”, në Drejtorinë e Kulturës Rinise dhe Sportit, në Komunën e Prishtinës, si rrjedhojë Kolegji, ka vlerësuar që pozita që mban ankuesi nuk hyn në kuadër të pozitave të nëpunësit civil as sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe as sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mirëpo sipas Aktgjykimin A.nr.1612/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Këshilli është obliguar që të detyroj organin e punësimit që të nxjerr aktin administrativ lidhur me deklarinimin e statusit të zyrtarit publikë për ankuesin.

Lidhur me këtë çështje, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ju referuar Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht dispozitave transitorë, nenit 83 paragrafi 5 i cili përcakton se: *“Një person, që mban një pozitë të Shërbimit Civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), e cila nuk është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë e saj sipas këtij ligji, do të përshtatet (rregullohet) me statusin e duhur të punësimit të përcaktuar sipas këtij ligji (punonjës i shërbimit publik, zyrtar i kabinetit, staf administrativ dhe mbështetës). Nëse personi refuzon të hyjë në këto marrëdhënie të tjera të punësimit, do të lirohet, sipas ligjit, nga Shërbimi Civil”*, ndërsa rregullimin e deklarinimit të zyrtarëve publikë e ka përcaktuar Rregullorja (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Fillimisht Kolegji, konstaton se institucionet e nivelit komunal hyjnë në kuadër të institucioneve tjera shtetërore siç parashihet me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nën paragrafit 1.6 të këtij neni, është përcaktuar se: *“Njësi përgjegjëse - është Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, të institucioneve të administratës shtetërore, përkatësisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të institucionit dhe të institucioneve të tjera shtetërore”*. Andaj nisur nga kjo, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, konkretisht sipas nenit 5 paragrafi 1, bëhet rregullimi i statusit të zyrtarit publik ndërlidhur me nenin 83 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht sipas paragrafi 2 të nenit 5 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, është përcaktuar se: *“Rregullimi i statusit sipas paragrafit 1 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse në njërin nga mënyrat e mëposhtme: 2.1. rregullimin e statusit të punësimit si nëpunës i shërbimeve publike; 2.2. rregullimin e statusit si nëpunës i kabinetit; 2.3. rregullimin e statusit si nëpunës administrativ dhe mbështetës”*.

Po ashtu Kolegji konstaton se gjatë rregullimit duhet aplikuar dispozitat e nenit 4 paragrafi 4, 5, 6 dhe 7 të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, ndërsa deklarimi bëhet me vendim nga njëjësia përgjegjëse siç parashihet me nenin 5 paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, ndërsa vendimi merret në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga të lartcekurat, Kolegji konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, në pajtim me këtë vendim, është obliguar që të bëjë rregullimin e statusit të zyrtarit publikë për ankuesin në pajtim dispozitat e lartcekura.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

***Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr. 708/2022***

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

